



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 164, datë 14.08.2019**

**PËR**

**DISA SHTESA NË RREGULLOREN NR. 85, DATË 03.07.2017 “MBI LICENCIMIN  
DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË VLERËSUESIT TË DËMEVE NË  
SIGURIME” E NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe nenit 227, pika 5 të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- I. Miratimin e disa shtesave në Rregulloren nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar, si vijon:
  1. Në nenin 3, pika 1, në fund shtohet një paragraf me këtë përmbajtje :

“Dokumentacioni i parashikuar në shkronjën “d” dokument që vërteton eksperiencën 3-vjeçare në vlerësim dëmi, nuk kërkohet në rastin kur kandidati e ka paraqitur kërkesën pas 6 muajve nga mbarimi i afatit të licencës së vlerësuesit të dëmeve, meqenëse sipas nenit 7, pika 2 të kësaj rregulloreje, kërkesa konsiderohet si kërkesë për licencë të re.”
  2. Në nenin 14, bëhen këto shtesa:
    - i) Në pikën 1, pas shprehjes “shoqëri aksionare”, shtohet shprehja “ose shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”;
    - ii) Në pikën 2:

-Në shkronjën “a”, pas shprehjes “shoqëri aksionare”, shtohet shprehja “ose si sh.p.k”;

-Në shkronjën “d”, pas fjalës “Aksionari/ët”, shtohet shprehja “ose ortaku/ët”.

3. Në nenin 15, në pikën 1, bëhen këto shtesa:

- i) Në shkronjën “a”, pas shprehjes “shoqëri aksionare”, shtohet shprehja “ose sh.p.k”;
- ii) Në shkronjën “e”, pas fjalës “aksionarin/ët”, shtohet shprehja “ose ortakun/ët”.

4. Në Formularin A “Të dhëna të përgjithshme mbi vlerësuesin e pavarur të dëmeve në sigurime”, që i bashkëlidhet rregullores, në rubrikën e shtatë, pas fjalës “Aksionarët”, shtohet shprehja “ose ortakët”.

II. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin KOÇI**